



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:209292

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05640168

P.nr.466/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri, me procesmbajtëse Erblina Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurit B. S., për shkak të veprës penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 par. 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 2586/2023, të datës 26.09.2023, në shqyrtimin fillestar të hapur për publikun, të mbajtur me datë 29.04.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Rukije Sheshivari dhe të pandehurit, me datë 30.04.2024 mori dhe publikisht shpalli, të njëjtën ditë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri,

B. S., nga i ati V. dhe nëna F. e vajzërisë K., i lindur më ... në P., me adresë banimi në rr. “H. Sh.”, nr. ..., lagja K., P., me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion punëtor sigurimi në Kompaninë e Sigurimeve “K.. e R..”, invalid i luftës, i martuar, baba i tre (3) fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

S e p s e :

Me datë 10.03.2023, rreth orës 23:25, në fshatin B. të Komunës së P., pa autorizim ka poseduar substancë narkotike në atë mënyrë që zyrtarët policor e kishin ndaluar derisa kishte qenë duke udhëtuar me veturën e tij të tipit G..., me targa ..., së bashku me dy pasagjer të tjerë dhe se gjatë kontrollit në trupin e të pandehurit kishin gjetur substancën të llojit ..., me peshë të përgjithshme prej ... gram.

- me këtë ka kryer veprën penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 par. 2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit si më lartë dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe neneve 242, 364, 367 të KPPRK-së, nenit 8.1, pika 8.1.4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të pandehurin e:

## G J Y K O N

- I. ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej njëqind e pesëdhjetë (150) Euro, të cilën detyrohet ta paguajë në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe
- II. Gjukata e liron të pandehurin nga pagesa e taksave gjyqësore ngase i njëjti ka statusin Invalid i UÇK-së, sipas kartelës me nr. rendor ..., e datës 21.08.2023, lëshuar nga Shoqata e Invalidëve të UÇK-së, me validitet deri me datë 21.08.2024.
- III. KONFISKOHET substanca narkotike e llojit ..., me peshë të përgjithshme prej ... gram, si mjet i kryerjes së veprës penale.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP.II.nr.2586/2023, të datës 26.09.2023, kundër të pandehurit B. S., për shkak të veprës penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 par. 2 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjyqtari i vetëm gjykues ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 29.04.2024, në të cilën pasi bindet se i pandehuri e kupton aktakuzën, në kuptim të nenit 241 par. 4 të KPPRK-së, të njëjtit i ofrojë mundësinë e deklarimit rreth fajësisë - të pranojë fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar pranoi fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, shprehu keqardhje mirëpo sipas tij është i detyruar ta përdorë të paktën njëherë në javë për shkak të traumave dhe përjetimeve të luftës, për arsye se disa situata nuk mund t'i tejkalojë pa përdorimin e tyre.

Gjyqtari i vetëm gjykues konstaton se i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike, andaj gjatë marrjes në konsideratë të pranimi të fajësisë nga i njëjti, gjyqtari i vetëm gjykues mori pikëpamjet e prokurorit të shtetit, i cili u pajtua e pranimin e fajësisë nga i pandehuri ngase sipas tij pranimi i fajësisë është bërë konform dispozitave ligjore të KPPRK-së si dhe me provat që gjenden në shkresat e lëndës, andaj gjykatës i propozoi që si të tillë ta aprovoj.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas pranimi të fajësisë nga i pandehuri si dhe marrjes në konsideratë të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se në veprimet inkriminuese të pandehurit të ndërmarra në kuadër të dashjes së tij, manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 par. 2 të KPRK-së, andaj pasi

që më parë gjeti se në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi..

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjyqtari i vetëm gjykues mori parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që si rrethana lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri, keqardhjen e shprehur për veprimet e tij, sjelljen korrekte të tij në gjykatë, ndërsa si rrethana nuk gjeti, andaj ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, me bindje se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në bazë të nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 8.1, pika 8.1.4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Vendimi mbi konfiskimin është marrë në bazë të nenit 269 par. 3 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë dhe në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË,  
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal  
P.nr.466/2024, Datë 30.04.2024

Procesmbajtëse  
Erblina Aliu

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Besnik Sheqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.